

ARGUMENTUM

news opinion analysis



EKSKLUZIVE

Ambasadori i Kosovës në Shqipëri z. Skënder Durmishi: Jemi një komb, me dy shtete. Mund të bëjmë më shumë për njëri-tjetrin!

- “Fetullah Gylen, një jetë në shërbim”/Dr. Jon Pahl: Gyleni është si Gandi, një ndërtues paqeje!

-Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut: Nuk ka dritë në fund të tunelit

-IX Global Baku Forum / President Meta: TAP, an alternative energy source for the region and Europe

-100 ditët e para të luftës së Rusisë në Ukrainë/ Ambasadori Shkurov: Veprimet e Rusisë mund të çojnë në një krizë globale ushqimore!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Bojko Borisov (zh)bllokoi integrimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

06 JO VETEM LAJMI

- Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut: Nuk ka dritë në fund të tunelit.
- 100 ditët e para të luftës së Rusisë në Ukrainë/ Ambasadori Shkurov: Veprimet e Rusisë mund të çojnë në një krizë globale ushqimore!

08 REALPOLITIK

- Midis tre zjarresh! 2 ditë, 5 shtete, 15 probleme! Të shtrëngojmë rradhët! Çfarë mbeti nga Samiti i SEECPS-së? Tre të mëdhenjtë e BE-së në Kiev!

10 INTERVISTA

- Ekskluzive/ Ambasadori i Kosovës në Shqipëri z. Skënder Durmishi: Jemi një komb, me dy shtete. Mund të bëjmë më shumë për të përkrahur njëri-tjetrin!
- “Fetullah Gylen, një jetë në shërbim”/Dr. Jon Pahl:

Gyleni është si Gandhi, një ndërtues paqëje!
Intervistë me autorin ekskluzivisht për Argumentum.al

ENGLISH EDITION

17 INTERVIEW

- “Fetullah Gülen, a life in service”/Dr. Jon Pahl: “Gülen is like Gandhi, a peacebuilder”. Exclusive interview with the author Dr. Jon Pahl exclusively for Argumentum.al.

17 TOP NEWS

- Albania and North Macedonia fail again to open accession talks with the EU.
- Albania and Kosovo sign 19 agreements in 8th joint governments’ meeting in Pristina.
- IX Global Baku Forum / President Meta: TAP, an alternative energy source for the region and Europe.

17 IN FOCUS

- US ex- vice president Mike Pence meets NCRI President-elect Maryam Rajavi in Tirana and Albanian politicians

Bojko Borisov (zh)bllokon integrimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut

Lojërat politike Ballkan-BE janë demaskuar si asnjëherë tjetër përgjatë 48 orëve, pas disa deklaratave politike nga Tirana në Beograd e nga Bullgaria në Bruksel.

Një “lojë shahu” politiko-diplomatik, ku “shah-matin” e bëri vetë ish-Kryeministri bullgar Bojko Borisov.

Ndërsa jemi në fund të presidencës franceze të BE-së pas 6-muajsh të kryesimit të saj nga Franca, duket se asgjë e re në horizont nuk shfaqet për Ballkanin Perëndimor.

Në fakt kjo ishte e pritshme duke marrë në konsideratë vizionin e Macron për Europën, ku zgjerimi i saj nuk përfshihet.

Mjafton të kthehemi në fillim të marrjes së Presidencës 6 mujore të BE, ku Presidenca Franceze shpalosi tre ambicie:

Një Evropë më sovranë: duke forcuar zonën Shengen, duke mbrojtur kufijtë evropianë, duke kontrolluar migracionin dhe duke përmirësuar politikën e azilit, në përputhje me vlerat e Evropës.

Një model i ri evropian për rritje: për ta bërë Evropën një tokë të prodhimit, krijimit të vendeve të punës, inovacionit dhe përsosmërisë teknologjike.

Një Evropë humane: që dëgjon shqetësimet e shprehura nga qytetarët e saj përmes Konferencës për Ardhmërinë e Evropës;



Megjithatë shumë pak u fol dhe u bë konkretisht për këto priorite pasi Macron kishte në fokus fushatën presidenciale ku fitoi një mandat të dyte si President i Francës. Gjithashtu sulmi rus në Ukrainë i shfokusoi prioritetet e Macron.

Gjithsesi Macron nuk hoqi dorë nga vizioni i tij për Europën, tashmë të transformuar në atë që e quan “Komunitet Politik Evropian”.

E pra 6 muaj pas presidencës franceze, jemi ende në fazën e ideve. Presidenti francez Macron në samit do iu prezantojë homologëve idenë e krijimit bren-

da vitit të një komuniteti politik evropian plus shtetet ballkanike, Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia”.

Përtej kësaj, “Këshilli Evropian ka vendosur t’i japë statusin e vendit kandidat Ukrainës dhe Republikës së Moldavisë,” në samitin e BE të enjten (23 qershor).

Ndërsa Ballkani Perëndimor është vendnumëro. Peng i vetos bullgare.

Kjo bëri që Kryeministri i Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe presidenti Serb, si kurrë me parë në kuadër të “Ballkanit të Hapur” të konsultoheshin për një vendim politik. Pjesëmarrjen ose

jo në samitin e datës 23 qershor 2022.

‘Ne diskutuam gjatë sot me liderët e Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut për Samitin e ardhshëm të BE-së. Duket se një tjetër “Jo, më fal!” do të jetë ajo që do të dëgjojmë në fund! I gjithë Unioni i rrëmbyer nga Bullgaria nuk është një spektakël i mirë për t’u parë! Çfarë duhet bërë atje?’- tha Rama.

Megjithëse është thënë vazhdimisht se Ballkani i Hapur, i krijuar nga liderët e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, është një nismë ekonomike që synon krijimin e një lëvizjeje të lirë të njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, ky vendim politik zgjoi jo pak kritika.

Madje ky vendim surprizoi Francën e cila ka shpallur një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Bullgari-Maqedoni e Veriut.

Një propozim ku ka trazuar politikën bullgare por dhe atë maqedonase.

Përmes një postimi në Facebook, Kovaçevski ka bërë të ditur se qeveria maqedonase ende nuk ka pranuar propozimin e Francës por në mënyrë që ai të jetë i pranueshëm ai kë thënë se “duhet respektuar dhe njohur gjuhën maqedonase, në kornizën negociuese dhe mbrojtje e qartë e identitetit maqedonas.

“Çështjet historike nuk mund të jenë kriter në kuadrin e negociatave. Negociatat mes Maqedonisë së Veriut dhe BE-së duhet të fillojnë para fillimit të procedurës për ndryshime kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve, kroatëve dhe malazezëve në preambulën e Kushtetutës. Çdo zgjidhje do të duhet të konsultohet me in-

stitucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ka thënë Kovaçevski.

Por ndërsa duket një bojkot ballkanas kundrejt bllokut evropian, “shpëtimi” erdhi po nga Bullgaria.

Ish-kryeministri bullgar, njëkohësisht dhe kreu i opozitës, Boyko Borisov i ka kërkuar kryeministrit Petkov që të sjellë propozimin për t’i hapur rrugën hapjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai është shprehur se 59 deputetët e tij do të votojnë pro.

I kam kërkuar deputetëve të GERB-it, nëse më besojnë, ta mbështesin propozimin, nëse Petkovi trembet, do të jenë 59 deputetë për t’i dhënë dritën jeshile Maqedonisë dhe Shqipërisë. Siç premtova, të shtunën lexuam tekstet për kornizën negociuese për Maqedoninë e Veriut. Unë besoj në Macron dhe KE, deri më tani gjithçka e mirë që ka ndodhur është falë BE-së”, shtoi Borisov.

I menjëhershëm ka qenë reagimi i Komisionerit për Zgjerimin në BE, Oliver Varhelyi.

“Falënderojmë liderin e opozitës Borisov për marrjen e një vendimi historik për Evropën dhe për pranimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut bazuar në propozimin francez që lejon vazhdimin me hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut. Ne presim që qeveria t’i bëjë propozimet e nevojshme Parlamentit sot në mënyrë që Evropa të mund të ecë përpara”, ka shkruar Varhelyi.

Kjo deklaratë zgjidhi dilemën 24 orëshe nëse liderët e Ballkanit Perëndimor do të shkonin në samit apo jo.

Në një postim në Twitter, Rama



“Çështjet historike nuk mund të jenë kriter në kuadrin e negociatave. Negociatat mes Maqedonisë së Veriut dhe BE-së duhet të fillojnë para fillimit të procedurës për ndryshime kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve, kroatëve dhe malazezëve në preambulën e Kushtetutës. Çdo zgjidhje do të duhet të konsultohet me institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ka thënë Kovaçevski.

shkroi se, “sapo dëgjova që diçka po lëviz sot në Bullgari. Shumë herët për të qenë optimist dhe shumë pak për të ndryshuar pjesën e fjalimit të nesërm ku Bullgaria kritikohet si një vend që ka rrëmbyer dy vende të NATO-s, ndërkohë që ka një luftë të nxehtë në kufirin e Evropës!”

“Ne do të marrim pjesë në mbledhjen e Këshillit të BE-së. Nuk do të ketë shumë për të dëgjuar për ne, por ne do të kërkojmë të dëgjohe mi për idenë e një Komuniteti të Ri Politik Evropian që ne mbështesim, për Ballkanin e Hapur që çon përpara frymën e Evropës dhe për rrëmbimin tonë nga Bullgaria që shkatërron atë”, u shpreh Rama.

Po ashtu Zyra e Presidentit të Serbisë njoftoi të mërkurën se liderët e nismës “Open Balkan” do të marrin pjesë në takimin me liderët e BE-së në Bruksel më 23

qershor. Një vendim i tillë është marrë pas “konsultimeve të detajuara dhe gjithëpërfshirëse” dhe përfaqëson “kontributin konstruktiv” të Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në procesin e integritimit evropian.

U zgjuan shpresat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, dhe për pak Borisovin do ta shpallnin “hero”.

Në fakt më parë Von Der Leyen foli për heqje të vetos në vendime të tilla, çka do të ndihmonte Maqedoninë e Veriut cila pret hapjen e negociatave që nga viti 2005 e bllokuar në fillim nga Greqia dhe tani nga Bullgaria.

“Në çështjet e politikës së jashtme, jam thellësisht e bindur se nuk është e qëndrueshme kërkesa për unanimitet. Zhvillimet aktuale në Ukrainë dhe rreth saj kërkojnë që përgjigja e BE të jetë e shpejtë, gjë që shpesh nuk ndodh pikërisht për shkak të kundërshtimeve të ngritura nga vetëm një shtet anëtar. Jam vërtet e bindur se na duhet një shumicë e kualifikuar. Në mbledhjen e Këshillit Evropian këtë fundjavë krerët e shteteve dhe qeverive të BE-së pritet të diskutojnë për statusin kandidat për Ukrainën dhe Moldavinë por edhe për marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Por Borisov tashmë “veteran” në politikë mori atributet e njeriut që bën kompromis.

Dhe në fakt ai di të bëjë kompromise.

Pasi vetëm pak orë më vonë pas deklaratës se tij, partia e tij do të rrëzonte qeverinë e re bullgare e cila zgjati me pak se vetë presidentin francez e BE-së.

Vetëm gjashtë muaj pas marrjes së detyrës, qeveria e koalicionit bullgar e kryesuar nga Kirill Pet-

kov për herë të parë në historinë demokratike bullgare rrëzohet me një mocion mosbesimi, duke shkaktuar paqëndrueshmëri të re politike .

Parlamenti i Bullgarisë votoi të mërkurën, 123 pro dhe 116 kundër dhe asnjë abstenim, për të miratuar një mocion mosbesimi kundër Qeverisë së Kiril Petkov, i cili u fut më 16 qershor nga grupi parlamentar më i madh i opozitës GERB-UDF lidhur me dështimin e supozuar të Kabinetit në fushën e financat publike dhe politikat e saj ekonomike.

Votat pro mocionit erdhën nga GERB-UDF (59), Lëvizja për të Drejta dhe Liri (33), Partia nacionaliste Vazrazhdane (12) dhe Ka një popull të tillë (TISP) (19), të cilat deri në një javë më parë ishte pjesë e koalicionit qeveritar. Kundër ishin deputetët e Vazhdo ndryshimin, BSP për Bullgarinë dhe Bullgarisë Demokratike.

Duke iu drejtuar legjislaturës pas votimit, kryeministri Petkov tha: “Ishte një nder për mua të drejtoja një qeveri që u rrëzua nga [udhëheqësi i GERB] z. [Boyko] Borisov, [udhëheqësi i TISP] z. për Bullgarinë] Znj. [Eleonora] Mitrofanova Ky votim është vetëm një hap i vogël në një rrugëtim shumë të gjatë, premtoj se do të vazhdojmë ta rifitojmë shtetin tonë dhe një ditë do të kemi një shtet evropian të suksesshëm, pa punë në prapaskenë dhe mafia. Faleminderit!”

Tashmë qeveria do të japë dorëheqjen. Presidenti duhet të fillojë konsultimet me partitë në Asamblenë Kombëtare. Më pas vijon prezantimi i mandatit të parë hetimor përpara forcës më të madhe politike – “Vazhdojmë ndryshimin”. Ata kanë 7 ditë kohë

për të mbledhur shumicën.

Nëse mandati kthehet, edhe partia e dytë që do të marrë mandat – në këtë rast GERB, do të ketë 7 ditë. Nëse e kthejnë mandatin, presidenti Radev do të ketë 7 ditë kohë për të zgjedhur palën e tretë për të tentuar formimin e kabinetit.

Nëse dështojnë, mandati do t'i shkojë grupit të dytë më të madh (GERB-UDF). Për përpjekjen e tretë të tillë, kreu i shtetit ka diskrecionin për të zgjedhur një grup tjetër. Nëse edhe ky mandat mbetet i paplotësuar, Presidenti duhet të emërojë një kabinet kujdestar, të shpërndajë Parlamentin dhe të caktojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare brenda dy muajsh.

Nisur nga procedurat, votimi pritet të mbahet në shtator ose tetor.

Pra në 48 orë të gjitha këto deklaratat dhe veprime politike, bënë që Boyko Borisov të dalë i fituari i vetëm. Me synimin që të rikthehet sërish në pushtet ai mbështeti propozimin francez paraditen e 22 qershorit, një propozim ende i paqartë, por që gjithsesi duhet miratuar nga parlamenti bullgar, ndërkohë po partia e Borisov e rrëzon qeverinë e Petkov po në të njëjtën ditë duke zvarritur edhe njëherë procesin e integritimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut drejt BE-së.

Sigurisht edhe Macron përfiton nga gjithë kjo mjegullajë ballkanike, por fundja ai ka një “Vizion” për Europën dhe për këtë është treguar gjithmonë koherent pavarësisht se liderit tanë bëjnë sikur nuk kuptojnë.

Ndaj asgjë e re në samitin e BE-së...të presim Borisov kur të zgjidhet sërish kryeministër.

Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut: Nuk ka dritë në fund të tunelit



Nga **Dimitar Bechev**

Pra, vetoja bullgare është kthyer në të kaluarën. Më 24 qershor, Asambleja Kombëtare në Sofje votoi me shumicë dërrmuese për të miratuar planin e paraqitur nga Presidenca Franceze e Këshillit të BE-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut. Mocioni, i paraqitur nga Partia e Bullgarisë Demokratike, fitoi mbështetje nga i gjithë spektri, me përjashtim të Rilindjes së ekstremit të djathtë (Vazrazhdane) dhe populistit Ka një popull të tillë (ITN). Dy ditë pasi një votë mosbesimi rrëzoi kabinetin e koalicionit të Kiril Petkov, partitë bullgare bënë një shfaqje uniteti. Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt bisedimeve të anëtarësimit

në BE tani është e qartë, narrativa vazhdon. Edhe Shqipëria nuk mbahet më, pasi ka qenë peng i vetos pasi oferta e saj është e lidhur efektivisht me atë të fqinjët të saj në BE.

Megjithatë, në Shkup nuk ka brohoritje. Për qeverinë maqedonase propozimi francez është një kupë e helmuar. Ai e lidh fillimin thelbësor të negociatave me një amendament kushtetues që fut bullgarët si një nga komunitetet konstituive të Maqedonisë së Veriut. Kjo është e vështirë të gëlltitet për maqedonasit pasi ata e perceptojnë një lëshim të tillë si kapitullim ndaj versionit bullgar të historisë së vendit të tyre. Sofja vë në pikëpyetje ekzistencën historike të një kombi maqedonas, sigurisht para vitit 1945, dhe e konsideron gjuhën maqedonase një dialekt bullgar.

Mosmarrëveshja ka rënë dhe ka

rrjedhur pothuajse që nga fillimi i viteve 1960, kur Partia Komuniste Bullgare përqafoi nacionalizmin dhe hoqi dorë nga miratimi i mëparshëm i kombësisë maqedonase deri më tani. Deri në vitin 1992, Shkupi mund të llogariste në predhën mbrojtëse të siguruar nga Jugosllavia. Por tani Bullgaria, një anëtare e BE-së që nga viti 2007, ka kthyer tavolinat dhe po shtrembëron krahun e Maqedonisë së Veriut. Duke marrë frymëzim nga Greqia, e cila për gati një çerek shekulli bllokoi maqedonasit, Sofja po përdor Brukselin për të ngacmuar fqinjin e saj. Kuptohet, taktika të tilla ngjallin një sasi të madhe pakënaqësie.

Në parim, qeveria e Maqedonisë së Veriut ka sinjalizuar gatishmërinë për të futur bullgarët në preambulën e kushtetutës; me shumë gjasa së bashku me kroatët dhe malazezët. Por ajo ka

insistuar ta bëjë këtë pasi filluan bisedimet e anëtarësimit. Shkupi gjithashtu dëshiron të mbajë marrëdhëniet dypalëshe jashtë negociatave, si dhe një lloj referimi për gjuhën dhe identitetin maqedonas në kornizën negociuese. Gjithashtu, ajo ka kërkuar garanci se Bullgaria nuk do të bllokojë bisedimet, duke paraqitur kërkesa shtesë. Megjithatë, propozimi francez i kushton pak vëmendje qëndrimit maqedonas.

Shumë vëzhgues të BE-së shohin një precedent të rrezikshëm. Për ta, Bullgaria po 'evropianizon' një çështje dypalëshe dhe, për rrjedhojë, po rrëmben zgjerimin. Kjo nuk është e paprecedentë. Përpara vitit 2013, Sllovenia bllokoi Kroacinë për një mosmarrëveshje territoriale në lidhje me gjirin e Piranit në Adriatik. Por ajo që është edhe më shqetësuese këtë herë është se kërkesat bullgare për të bërë me të kaluarën e kontestuar po integrohen zyrtarisht në kuadrin e negociatave, këto janë urdhrat e marshimit të përgatitura nga Këshilli i BE-së për Komisionin Evropian, i cili po kryen anëtarësimin aktual. bisedimet. Me fjalë të tjera, Unioni – duke përfshirë shtetet anëtare si Kroacia dhe Sllovenia, të cilat dikur ishin pjesë e Jugosllavisë – po sulmon kolektivisht Maqedoninë e Veriut për të kënaqur bullgarët.

Nuk duhet shumë imagjinatë për të imagjinuar Kroacinë duke bërë të njëjtin mashtrim me Serbinë apo Malin e Zi në të ardhmen. Shtetet anëtare mund të zhvillojnë një shije për rrëmbimin e politikave të BE-së. Këta kritikë pretendojnë se e vetmja mënyrë për të shpëtuar Zgjerimin, ose politikën e jashtme të BE-së më gjerësisht, është heqja e parimit



Mosmarrëveshja ka rënë dhe ka rrjedhur pothuajse që nga fillimi i viteve 1960, kur Partia Komuniste Bullgare përqafoi nacionalizmin dhe hoqi dorë nga miratimi i mëparshëm i kombësisë maqedonase deri më tani. Deri në vitin 1992, Shkupi mund të llogariste në predhën mbrojtëse të siguruar nga Jugosllavia. Por tani Bullgaria, një anëtare e BE-së që nga viti 2007, ka kthyer tavolinat dhe po shtrembëron krahun e Maqedonisë së Veriut.

të unanimitet në favor të votimit të shumicës së cilësuar (QMV). Nuk do të kishte më shpërblësë të mbajtur nga Bullgaria – apo Greqia, apo Hungaria, për këtë çështje!

Pavarësisht nëse sa më sipër është e realizueshme apo jo, një gjë është e sigurt: ju nuk do të dëshironit të ishit në këpucët e kryeministrit të luftuar të Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski. Ai po përballet me një situatë klasike “të mallkuar nëse e bën, mallkuar nëse nuk e bën”. Përkulja ndaj Bullgarisë mund t'i japë fund të hershëm mandatit të tij të shkurtër. VMRO-DPMNE partia nacionaliste e djathtë, e cila triumfoi në zgjedhjet lokale të vitit të kaluar, po i merr frymë në qafë. Dhe ajo kundërshton me vendosmëri propozimin francez.

Edhe më keq, Kovačevskit i duhen votat e DPMNE-së nëse dëshiron të miratojë amendamentet kushtetuese që kërkon Bullgaria – dhe potencialisht BE-ja në tërësi. Në të njëjtën kohë, Maqedonisë së Veriut i paraqitet një mundësi historike për t'u nisur përfundimisht në rrugën e

anëtarësimit. Shqipëria, dikur shumë prapa në radhë, me shumë gjasa do të nisë edhe bisedimet e saj. Edi Rama, pasi ka goditur me ditë të tëra Bullgarinë, tashmë ka ndryshuar melodi. Ai falënderoi ish-kryeministrin Bojko Borisov (për ironi, personi përgjegjës për veton) që u siguria që votimi në parlamentin bullgar të kalonte. Kovačevski ka mbetur vetëm. Ai është tërhequr në drejtime të ndryshme nga BE dhe nga zgjedhësit e tij. Kryeministri e hodhi poshtë propozimin francez, por mund ta ketë të vështirë të mbajë qëndrimin e tij.

Duket sikur Bullgaria ka bërë një grusht shteti të madh diplomatik duke mbledhur BE-në për kauzën e saj. Megjithatë, në planin afatgjatë, kjo është një fitore e Pirros. Politikanët bullgarë kanë tjetërsuar një popull që, sipas teksteve shkollore, është i afërmi i tyre etnik. Beteja për zemrat dhe mendjet që gjoja zhvilloi Sofia, është e humbur. Disa nga dëmtimet mund të riparohen përfundimisht, por do të duhet një kohë e gjatë. Sherri i fqinjësisë ndoshta do të zbutet, por mund të rikthehet me hakmarrje shumë shpejt.

100 DITËT E PARA TË LUFTËS SË RUSISË NË UKRAINË

Ambasadori Shkurov: Veprimet e Rosisë mund të çojnë në një krizë globale ushqimore!

Ndërsa jemi në 100 ditët e para të luftës së Rosisë në Ukrainë, Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri Volodymyr Shkurov në një koment për Argumentum.al paralajmëron rrezikun me të cilin mund të përballet e gjithë bota, një krizë globale ushqimore, madje deri në zi buke.

“Rusia ka bllokuar portet detare të Ukrainës, ka minuar zona të detit dhe vazhdimisht po përpiqet të depërtojë në mbrojtjen e Odesës dhe qyteteve të tjera bregdetare në Detin e Zi. Ukraina ka humbur tashmë mundësinë për të eksportuar produkte bujqësore nga deti. Rreth 22 milionë tonë drithë janë ngecur në porte dhe nuk mund të arrijnë tek konsumatorët, veçanërisht në Afrikë dhe Azi”, thekson Ambasadori.

Ai ka një thirrje për Rusinë që të zhbllokojë menjëherë portet detare të Ukrainës, të ndalojë bombardimin e Odesës dhe qyteteve të tjera bregdetare, të tërheqë marinën e saj në një distancë që do ta bëjë të pamundur sulmin ndaj anijeve tregtare dhe të mos krijojë pengesa për lundrimin ndërkombëtar.

Gjithashtu Ambasadori Shkurov thekson se Ukraina mbetet e përkushtuar për të gjetur mënyra për të zhbllokuar rrugët në Detin e Zi dhe Azov për të parandaluar një krizë të zgjatur globale të ushqimit, por nga ana tjetër ai u bën thirrje vendeve, siguria ushqimore e të cilave mund të vuajë më shumë nga agresioni rus kundër Ukrainës, të përdorin kontaktet e tyre me Moskën për ta detyruar atë



të heqë bllokadën e porteve detare të Ukrainës dhe t'i japë fund luftës.

Koment i Ambasadorit Volodymyr Shkurov

Pas sulmit ndaj Ukrainës, Rusia ka bllokuar portet detare të Ukrainës. Ushtria ruse ka minuar zona të detit dhe vazhdimisht po përpiqet të depërtojë në mbrojtjen e Odesës dhe qyteteve të tjera bregdetare në Detin e Zi.

Si rezultat i bllokadës së Rosisë, Ukraina ka humbur tashmë mundësinë për të eksportuar produkte bujqësore nga deti. Rreth 22 milionë tonë drithë janë ngecur në porte dhe nuk mund të arrijnë tek konsumatorët, veçanërisht në Afrikë dhe Azi. Rrugët alternative tokësore nuk do ta zgjidhin plotësisht problemin, pasi ato kanë gjerësi të ulët. Për më tepër, Rusia po vjedh grurin ukrainas në territoret e pushtuara për t'ua shitur ilegalisht vendeve të treta.

Veprimet e Rosisë mund të çojnë në një krizë globale ushqimore dhe, në disa rajone, në një zi buke. Rusia duhet të zhbllokojë menjëherë portet detare të Ukrainës, të ndalojë bombardimin e Odesës dhe qyteteve të tjera bregdetare, të

tërheqë marinën e saj në një distancë që do ta bëjë të pamundur sulmin ndaj anijeve tregtare dhe të mos krijojë pengesa për lundrimin ndërkombëtar.

Ukraina diskuton me partnerët mënyrat për të krijuar një mision ndërkombëtar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, i cili do të marrë përsipër funksionimin e rrugëve detare për eksportin e mallrave bujqësore ukrainase. Ne mirëpresim gatishmërinë e një numri vendesh për t'iu bashkuar procesit të rivendosjes së sigurisë në Detin e Zi dhe Detin Azov.

Si hap i parë, Rusia duhet të tërheqë forcat e saj nga ujërat territoriale të Ukrainës dhe të ofrojë garanci sigurie kundër sulmeve ndaj porteve dhe autokolonave tregtare.

Ukraina mbetet e përkushtuar për të gjetur mënyra për të zhbllokuar rrugët në Detin e Zi dhe Azov për të parandaluar një krizë të zgjatur globale të ushqimit. Ne u bëjmë thirrje vendeve, siguria ushqimore e të cilave mund të vuajë më shumë nga agresioni rus kundër Ukrainës, të përdorin kontaktet e tyre me Moskën për ta detyruar atë të heqë bllokadën e porteve detare të Ukrainës dhe t'i japë fund luftës.

Midis tre zjarresh! 2 ditë, 5 shtete, 15 probleme! Të shtrëngojmë rradhët! Çfarë mbeti nga Samiti i SEECIP-së? Tre të mëdhenjtë e BE-së në Kiev!

REALPOLITIK "FLASH" NO. 45 | 3 - 16 MAJ 2022

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik

DR. JORGJI KOTE

1. Midis tre zjarresh ndodhet aktualisht "Ballkani i Hapur". Kjo u pa qartë dhe në Samitin e Ohrit më 8 Qershor. Nga njera anë Procesi i Berlinit dhe nga tjetra "Tregu i Përbashkët Rajonal". Të dyja të iniciuara dhe mbështetura politikisht dhe financiarisht nga BE dhe SHBA-të. Vetë "Ballkani i Hapur" ka mbetur gjysmak, ndonëse u mundua t'i jepte pak oksigjen politik Abazovici. Gjithandej shtrohet pyetja pse na duhet një nismë tjetër kur "na del e tepëron" Procesi i Berlinit dhe "Tregu i Përbashkët" me njësitë e tyre të njohura – CEFTA, RCC-ja, Komuniteti Energjistik dhe i Transportit Rajonal! Ca më tepër kur përditë dalin fakte që e dëshmojnë Ballkanin e Hapur si nismë serbe me mbështetjen ruse. E tha këtë me gojën e tij vetë Lavrovi, por disa nuk duan ta dëgjojnë. Kësaj i thonë "i zoti e shet, tellalli se jep"!

Vatra e tretë e "Zjarrit" është Kosova, e cila me shumë të drejtë e refuzon kategorikisht këtë nismë. Me argumentat e sipërpërmendura dhe kërkesën e drejtë të Kryeministrit Kurti që "përpara se Serbia të hapë Ballkanin, ajo duhet të hapet para Kosovës" Ndaj, boll më me propagandë, nëse Serbia e do vërtet Ballkanin e Hapur, le ta njohë genocidin ndaj Kosovës, ta njohë atë si shtet, të heqë dorë nga



fushata e çnjohjeve dhe pengimi i antarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, TANI! Ja pse, Ballkani i Hapur ndodhet jo midis dy, por tri zjarresh. Se si do t'i "shuajnë këto zjarre", këtë e dinë ata të Ballkanit të Hapur; por le ta themi shqip dhe kjo duket sheshit se Ballkani i Hapur "ka lemun i dekun"

2. 2 ditë, 5 shtete, 15 probleme ishte me pak fjalë vizita e Kancelarit gjerman Olaf Scholz në Prishtinë, Beograd, Shkup dhe Sofje. Shumë e ngjeshur me 15

megatema të vështira për arritje të menjëhershme, ku spikatin: dialogu Prishtinë – Beograd dhe njohja e Kosovës nga Beogradi, si si kusht antarësimi në BE, liberalizimi i vizave me Kosovën, linjëzimi i Serbisë me BE-në lidhur me vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë, çbllokimi i vetos bullgare për çeljen e negociatave me Shkupin dhe Tiranën dhe rijetësimi i Procesit të Berlinit.

Këtë të fundit e ai trajtoi dhe në Darkën me liderët e rajonit gjatë Samitit të SEECIP-së në Selanik.

“

10 geopolitical miscalculations with catastrophic costs for Ukraine, Europe and Russia were made by Putin. Both at home and abroad, for today and tomorrow. His mistakes remind us of Bonaparte, who after the invasion of Spain was trying to justify himself saying that after all he had not committed any crime; but the great Talleyrand gave him with great concern the emblematic answer "No, Your Majesty, it is even worse, you have committed a mistake".

Tema tejet të vështira, natyrisht pa pretendime për zgjidhjen e tyre me “shkopin magjik” për të cilën janë angazhuar SHBA-ë dhe BE-ja. Por, gjithsesi me sinjale pozitive për mbështetjen gjermane në këto procese.

3. Të shtrëngojmë radhët! Ky ishte në fakt, objektivi i vizitës së Presidentit të Këshillit European Charles Michel më 14/15 Qershor në Prishtinë, Beograd, Shkup dhe prania e tij në Samitin e SEECP_së në Selanik më 10 qershor. Fjala është për vizionin e ri që ai shpali më parë dhe në Tiranë për “Komunitetin e ri gjeopolitik European”, identitetik me idenë e Presidentit Macron, por me një “gjeo” më shumë. Një ide që ka krijuar shumë telashe, debate, dyshime, hamendësime dhe zhgënjime në Ballkanin Perëndimor, në Ukrainë dhe gjatë. Por, tashmë kjo është vendosur, pavarësisht nga nuancat dhe ndryshimet që do t'i bëhen në formulime, një art i vërtetë ky për BE-në; sepse prapaa saj janë Franca dhe vende të tjera me peshë! Tani çështja është që në Samitin e BE-së më 23/24 Qershor, ku do të jenë të ftuar dhe 6 liderët e rajonit, prej tyre të mos ketë rezistencë, por vetëm “të shtrëngojnë radhët” dhe të pozicionohen qartë në fa-

vour të kësaj nisme. Ajo do të na lerë praktikisht në rrethin e dytë apo të tretë të BE-së, me shumë përfitime, me “kulaç” kur gjërat të ecin mirë, por dhe sanksione, pra me “kërbaç” anasjelltas. Ndërsa antarësimi, siç duken bathët” dhe ashtu sikundër kemi shkruar më parë, do të shtyhet vërtet në kalenda greke.

4. Çfarë mbeti nga Samiti i SEECP-së? Samiti i Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore (SEECP) u zhvillua në Selanik më 10 Qershor, me rastin e dorëzimit të kryesisë greke të Mali i Zi për vitin 2022-2023. SEECP u krijua më 1996 në Sofje. Ajo është “ombrella” politike e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) që drejtohet nga Majlinda Bregu. Në fakt, pas antarësimit të 11 vendeve ish lindore në BE dhe NATO, roli i SEECP ka rënë, aq sa rrallë i dëgjohet dhe emri. Këtë radhë, atë e lanë dhe më shumë në hije problematikat e nxehta rajonale që u përmendën më sipër. Atmosferën e tij e rënduan më tepër kërcënimet e Erdoganit ndaj Greqisë në prag të saj. Kësisoj, jehona e tij ishte pothuajse NUL. Dhe thirja e Mitsotakis për antarësimin e vendeve të rajonit në BE më 2033 u konsiderua thjesht dëshirë e mirë greke, por aq! Ca

më tepër se siç e përmendëm pak më lart, pas 24 Qershorit nuk do flitet më për negociata dhe antarësim, por për përkatësi europiane.

E, sikur të mos mjaftonin këto tersllëqe, Greqisë “ia vodhi” dhe atë pak sukses jehona e dy incidenteve alla shqiptare. Fotot e Presidentes Osmani dhe ato të Edi Ramës, dëshmi e marrëdhënies jo normale ndërmet liderëve të Kosovës dhe Shqipërisë. Por më seriozi ishte incidenti diplomatik i Kryeministrit Rama kur gjatë prezantimit të Kancelarit Scholz me homologun maqedonas nga mikpritësi Mitotakis, kundër çdo protokolli elementar diplomatik, Rama e paraqiti Kovaçevsin si “kryeministër të Bullgarisë Perëndimore”!

Epajustificueshme dhe ofenduese kjo “shaka pa kripë” për të Zotin e shtëpisë, Kovaçevskin, Petkovin dhe vetë Scholz. Sqarojmë se asnjë lider tjetër perëndimor dhe në aktivitetet më të thjeshta, le më raste të tilla nuk përdor kunja, thumba, batuta dhe ironi, sepse ato prishin atmosferën dhe krijojnë dyshime të pranishmit. Le të mësojnë liderët tanë dhe në këtë aspekt nga Macron, Draghi, Scholz, Merkel, Sanchez dhe Mitsotakis; që të mos bëjnë më sjellje të tilla politike që janë shpallur me kohë “non – grata”

5. Tre të mëdhenjtë europianë në Kiev! Më 16 Qershor, Presidenti Macron, Kancelari Scholz dhe Kryeministri Draghi vizituan Kievin. Vizitë historike nga liderët e tri vendeve më të mëdha dhe bashkëthemeluese të BE-së, me shumë angazhime, pritshmëri dhe mesazhe për Ukrainën dhe Rusinë.

Demonstrim real i unitetit europian përkrah SHBA-ve! Efektet e tij do të shihen brenda muajit në Samitin e BE-së dhe të NATO-s.



EKSKLUZIVE/ Ambasadori i Kosovës në Shqipëri z. Skënder Durmishi: Jemi një komb, me dy shtete. Mund të bëjmë më shumë për të përkrahur njëri-tjetrin!

Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Shqipëri Z. Skënder Durmishi



INTERVISTOI: MARJANA DODA

Shqipëria dhe Kosova, përveç historisë dhe sentimenteve, shumicën e orientimeve strategjike i kanë të njëjta, por mund të bëjmë më shumë për të përkrahur njëri-tjetrin, në të gjitha fushat”, kështu shprehet në një intervistë ekskluzive

për Argumentum.al Ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipëri Z. Skënder Durmishi.

“Kosova me përvoja solide të ndërtimit të shtetit, me potenciale të mira ekonomike, është adresa e parë bashkëpunuese e Shqipërisë. Kosova që po ndërton shtet modern me standarte demokratike të

avancuara, është argument i fuqishëm për Shqipërinë, për mbështetje në politikën e jashtme, në çdo nivel. Për fat të mirë Shqipëria është anëtare dhe e pranishme në shumë instanca e organizata ndërkombëtare ku Kosova ende nuk është anëtare. Kjo është përparësi edhe për ne”, thekson ambasadori.



Intervista e plotë:

-Argumentum.al: I nderuar Ambasador fillimisht më lejoni t'ju falendëroj që pranuat të jepni këtë interviste ekskluzive për Argumentum.al. Si i konsideroni marrëdhëniet aktuale midis Kosovës dhe Shqipërisë, si politikisht dhe ekonomikisht?

– SH.T.Z Skënder Durmishi: Çdo përgjigje në këtë pyetje duhet të filloj nga konstatimi se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë janë speciale. Në terma konkrete të forcimit të bashkëpunimit mund të flasim për raporte shumë të mira. Edhe politikisht dhe ekonomikisht. Pse them shumë të mira? Sepse nuk ka asnjë pengesë, asnjë problem, asnjë kufizim në komunikimet tona të të gjitha llojeve! Trend normal dhe në rritje të bashkëpunimit!

Marrëdhëniet tona, edhe ekonomike edhe politike, sipas të dhënave e statistikave, janë më mirë se çdo herë tjetër në të kaluarën. Këmbimet tregtare që stagnuan gjatë pandemisë po stabilizohen e po shënojnë rritje, komunikimet politike, vizitat e ndërsjella, takimet e drejtuesve të dikastereve qeveritare, delegacioneve parlamentare, etj, janë aktive, të rregullta. Disa madje janë me rezultate rekorde, siç janë takimet dhe vizitat e delegacioneve parlamentare. Janë relaksuar kufizimet burokratike në vendkalimet kufitare. Ka fare pak pritje për procedura doganore të mallrave. Orientimi dhe përcaktimi është që të ketë edhe më tej lehtësime. Siç e dini u formua këto ditë grupi punues për të parë madje mundësitë e unionit doganor... Mbase nuk ka nevojë të them diçka për dinamikën e vizitave turistike. Në kulturë po ecën mirë kalendari vjetor i përbashkët i dy minis-

Marrëveshjet që nënshkruam ditë më parë, në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, kanë për qëllim kryesor thellimin e bashkëpunimit ekonomik, para së gjithash, por edhe në shumë fusha të tjera, si në shëndetësi, energjetikë, infrastrukturë, bujqësi, arsimit universtar, lehtësime në brezin kufitar, gjendje civile...

trive. Kjo është ana zyrtare e institucionale e kulturës. Kësaj mund ti shtohet dinamika në rritje e komunikimeve të bizneseve, të këngtarëve ne iniciativa private... këngëtarët e Kosovës këtu janë shumë të popullarizuar dhe janë vazhdimisht nëpër skena, klube etj. Gjatë sezonit janë gjithandej të pranishëm në klube, plazhe.

Pra, të dhënat janë në trend rritjeje. Ato mund t'i gjeni në çdo buletin statistikash, këtu ose në Kosovë.

Këto që përmenda janë fakte. Mirëpo, nuk mjafton dhe nuk duhet të krahasohemi me vetëveten, me të djeshmën tonë. Besoj se duhet të nisemi nga konstatimi se mundemi më shumë, të synojmë më shumë. Kemi potenciale për më shumë. Ekspertët e ekonomisë tashmë na kanë thënë se ekonomitë tona janë komplementare, mund të jenë edhe më të mirë treguesit e bashkëpunimit ekonomik. Mbetet sfidë dhe objektiv, duke çmuar realisht

këto që kemi bërë.

– Duke qëndruar të marrëdhëniet politike dhe ekonomike. Në mbledhjen e 8-të mes qeverisë së Shqipërisë dhe të Kosovës, mbajtur në Prishtinë, u firmosën 19 marrëveshje dhe memorandume mirëkuptimi në disa fusha. Çfarë impakti do të kenë këto marrëveshje në ekonominë e Kosovës por dhe të Shqipërisë?

Marrëveshjet që nënshkruam ditë më parë, në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, kanë për qëllim kryesor thellimin e bashkëpunimit ekonomik, para së gjithash, por edhe në shumë fusha të tjera, si në shëndetësi, energjetikë, infrastrukturë, bujqësi, arsimit universtar, lehtësime në brezin kufitar, gjendje civile...

Disa nga marrëveshjet janë bërë si vazhdimësi me qëllime operacionale të marrëveshjeve nga Elbasani, disa të tjera janë për të adresuar çështje që janë aktualisht me rëndësi të adresohen, si kërkesë e këtij momenti. Por, të gjitha shkojnë në drejtim të krijimit të kushteve për thellim bashkëpunimi. Ta zëmë brezi kufitar, adreson çështje teknike, relevante për të mundësuar komunikimet e banorëve në brezin kufitar, që do të thotë për të lehtësuar jetën e tyre, ekonomitë familjare. Ose në këtë sens, është edhe rregullimi i rrugëve të fshatrave në afërsi të kufirit. Çka thotë kjo marrëveshje? Pra, qeveritë marrin përsipër të përmirësojnë infrastrukturën rrugore në fshatarat e brezit kufitar të cilat, për arsye të njohura, (paranoja të kohës së regjimeve komuniste) qëllimisht i linin këto fshatara në gjendje izolimi, me komunikime tepër të vështira. Do të thotë synohet të ndryshohet kjo gjendje, këtë po e bëjnë dy qeveritë tona.

– Samiti i 23 qershorit ishte

tejet zhgënjyes për Ballkanin Perëndimor e veçanërisht për Kosovën e cila as kësaj here nuk mori dritë jeshile për liberalizimin e vizave. Ndërkohë janë me qindra qytetarë të Kosovës që marrin pashaporte Shqiptare. A është kjo një formë përbashkimi Shqipëri-Kosovë?

Kjo punë e vizave është edhe përtej zhgënjimit, po merr trajtë absurdi! Janë thënë tashmë e sterthënë arsyet e zhgënjimit tonë. Meqë po më shtroni këtë pyetje, po më duhet të përsërisë komentet ose arsyet e zhgënjimit. Janë kërkuar kushte Kosovës, ato kushte janë plotësuar deri në një. Madje janë dhënë edhe vlerësime afirmative e komplimente Kosovës nga zyrtarë të BE-së e të vendeve anëtare. Parlamenti ka dhënë rekomandime zyrtare. Por, nuk erdhi ajo përgjigje pozitive, se nuk erdhi! No koment! Ka zhgënjim sepse jemi të vetmit në rajon me këtë kufizim. Ka zhgënjim sepse kemi plotësuar kushtet e kërkuara, e megjithatë vazhdojmë të jemi të vetmit në rajon, të izoluar, pa mundësi udhëtimit. Brezi im kujton kohën kur kosovarët mund të udhëtonin tërë Evropën pas vizë. Sidoqoftë, asesi nuk ka pendim për kushtet e plotësuar. Sepse ato kushte e kritere janë plotësuar me dëshirë, si hapa e veprime që janë në interesin tonë, për sundim të ligjit dhe institucione efikase demokratike. Do të vazhdojmë edhe më tej sepse BE-në e kuptojmë edhe si vlerë, madje para së gjithash si vlerë. Pastaj vijnë avantazhet e tjera.

Puna e pasaportave të Shqipërisë është e veçantë, nuk do ta lidhja me çështjen e liberalizimit të vizave. Pasaportat e Shqipërisë jepen për raste të caktuara, me kushte të caktuara. Kush i plotëson mund të drejtohet tek autoritetet shtetërore të Shqipërisë, por fokusi jonë, mbetet vazhdim

pa alternativa ai i kursit drejt BE-së, ku bën pjesë natyrshëm edhe liberalizmi i vizave.

-Z.Ambasador, prej 24 Shkurtit një luftë po zhvillohet në dyert e të Europës, a rrezikon Ballkani rikthimin e një konfliktit të hapur nisur edhe nga disa mosmarrëveshje që shkaktojnë herë pas here trazira si në Kosovë, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë?

Kur ndihet Evropa e kërcënuar si të mos jetë i kërcënuar Ballkani! Madje disa herë më

shumë, për shkaqe që dihen besoj. E para amfiteatri i luftimeve nuk është fare larg nga këtu ku jemi ne. Arsye tjetër për brenjosje është se, për fat të keq, në rajonin tonë ka qendra e individë me fuqi politike që këtë luftë në dyert të Evropës nuk e shohin si rrezik e si kërcënim. Por tregojnë simpati e solidarizim, ku të hapur e ku të heshtur. Edhe para se të ndodhte kjo luftë ne kemi parë veprime të kësaj natyre që si qëllim, shkojnë përtej mosmarrëveshjeve të brendshme, siç i quani ju. Janë yshtje nga jashtë vendeve që ju përmendet. Ju e dini se në Mal të Zi në vitin 2016



ndërhyrja targetonte direkt kreun e vendit, z.Gjukanoviq, në BeH ka tensione destabilizuese që ushqehen nga jashtë. Edhe ndaj Kosovës janë manifestuar tendeca të tilla, provokime në kufi etj.

-Pas pushtimit rus të Ukrainës, ekspertët thonë se BE-ja dhe SHBA-ja duan të mbështesin stabilitetin dhe orientimin euroatlantik të Ballkanit Perëndimor. A është ky një “momentum” për Kosovën që të konsolidohet në arenën ndërkombëtare?

Kjo mbështetje është e domosdoshme. Mbështetja e rajonit tonë, përkatësisht orientimi euroatlantik, garancia për demokraci liberale është mbështetje e rajonit por edhe e vetë Evropës. Zhvillimet në Ukrainë duket se e kanë bërë botën demokratike, sidomos BE-në, për reflektim serioz, që të jenë më të vendosura, më të koordinuara, që të evitojnë diskrepancat e qasjet indolente. Kjo gjendje po forcon dukshëm vetëdijën për rolin e pazëvendëseushëm të NATO-s, për fuqizim e zgjerim të Aleancës Veri Atlantike, por duhet të synohet edhe më shumë kohezion brenda BE-së.

A paraqet kjo një shans për Kosovën? Besohet se po sepse pas llahtarit mbi Ukrainën, janë më të besueshme qëndrimet tona, mund të dëgjohen më me kujdes e mirëkuptim. Në KiE aktualisht është pezulluar Rusia e cila vazhdon ende të jetë kundër anëtarësimit të Kosovës. Disa vende hezituese besoj se pas kësaj gjendjeje kanë shumë argumente që të jenë më pak hezituese lidhur me ne.

– Pothuajse janë bërë 11 vite që nga fillimi i dialogut Prishtinë-Beograd por përgjatë këtyre viteve janë bërë hapa shumë të vegjel dhe ndonjëherë kemi parë qëndrim vendnumëro.

Megjithate më në fund u arrit marrëveshja për zbatimin e marrëveshjes për energjinë mes Kosovës dhe Serbisë. A është Berlioni një garanci për një përmbyllje të sukseshme të këtij procesi duke pare edhe angazhimin e kancelarit gjerman?

Dialogu nuk është refuzuar asnjëherë nga ana e Kosovës. Serbia ka dashur vazhdimisht ta lëjë këtë përshtypje, madje ta imponojë si një fakt të kryer, duke e zhvendosur fokusin nga veprimet e saj shpesh destruktive dhe të kundërta me frymën dhe qëllimet e dialogut. Shumica e marrëveshjeve nuk janë zbatuar nga Serbia. Preferojnë që as të mos flasin fare, dhe të anashkalojnë bashkëpunimin, për çështjen kyçe e cila duhet tu prijë të gjitha dialogjeve, pra çështjen e të pagjeturve. Po kaq anti dialog është anashkalimi i detyrimeve për të zbatuar shpërbërjen e strukturave paralele. Prishtina kërkon rol aktiv, përfshirje të rregullt të subjekteve e strukturave serbe nga veriu i Mitrovicës në institucione legjitime të shtetit të Kosovës. Kjo është vetëm një segment, por mjaft i fortë, se qytetarët serbë dhe përfaqësuesit e tyre institucionalisht të jenë aktiv, pjesë kontribuese e shtetit të Kosovës, shtetit të tyre, ku të realizojnë prosperitetin e tyre. Por, dialogu nuk duhet ngatërruar me disa ide e veprime që flasin për dialogun por në fakt mendojnë për të diskutuar lidhur me statusin e Kosovës, ose mendojnë për në trajta e variacione me të cilat synojnë të pamundësojnë shtetin e Kosovës, pengimin e konsolidimit të pozitës ndërkombëtare, ndaljen e njohjeve të reja dhe antarësimeve në organizata ndërkombëtare. Këto gjëra janë të kundërtat e fqinjësisë së mirë. Për dialog të vërtetë, që synon normalizim të marrëdhënieve të dy shteteve tona fqinjë, që duhet

të përfundojë me njohje reciproke, Kosova është e gatshme dhe nuk i është shmangur asnjëherë. Dominojnë zërat se ujdja për zbatim të marrëveshjes për energjinë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ishte hap në drejtim të duhur, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Berlioni gjithësesi është një zë i fuqishëm dhe, për fat të mirë të rajonit, është edhe krejtësisht i qartë për kursin e që duhet të ndjek dialogu si kusht për BE-në.

-Kosova ka aplikuar zyrtarisht me 12 Maj për t’u bërë anëtare e Këshillit të Europës. Çfarë do të thotë kjo për shtetin e Kosovës dhe sa janë mundësitë që pikërisht Kosova të bëhet anëtare e KE duke zënë vendin e Rusisë e cila u përjashtua për shkak të luftës në Ukrainë?

Po, është e vërtetë. Kosova ka aplikuar sepse e meriton dhe do të jetë anëtare e veshme dhe e përkushtuar e KiE-së. Pse e meriton sepse të gjitha kushtet që kërkohen me rregullat e pranimit të anëtarëve të rinj, Kosova i plotëson, madje i tejkalon. Jemi në proces dhe optimist. Nuk do të ishte e drejtë as në frymën e praktikave dhe të natyrës së KiE-së që, për arsye e motive politike, të veprohet ndryshe. Ka sinjale e mesazhe të fuqishme të mbështetjes sidomos nga ato vende që e dinë se çfarë shoqërie, çfarë demokracie po ndërtohet në Kosovë. Që e dinë se cila është cilësia e ligjeve dhe e Kushtetutës, si të tilla dhe si bazë juridike e cila garanton zbatim të kriterëve edhe standardeve për të cilat shquhet Këshilli i Evropës. Po ju rikujtoj se Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës përmbajnë postulate e nene të veçanta, e të mjaftueshme për të garantuar zbatimin e standardeve për të cilat është themeluar Këshilli i Evropës- Demokracia, të drejtat e njeriut, etj. Madje me

zbatueshmëri direkte p.sh Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta e Kosovës me nene të veçanta (22) precizon se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet.

Krahas kësaj, fryma juridike e legjisllacionit të BE-së është pjesë e ligjeve të Kosovës. Nuk ka asnjë ligj që shkon ndeshë me to. Kosova pra de fakto është aty, praktikisht i zbaton kriteret dhe rregullat e KiE. Do të ishte e kuptueshme dhe e natyrshme që të bëhet anëtar i Këshillit të Evropës. Kjo do të na gëzonte, por do të ishte lajm i mirë edhe për KiE, do të ishte një zë më shumë në amplifikimin e vlerave dhe ligjeve të KiE-

-Armatosja e Serbisë ka shqetësuar jo pak qeverinë e Kosovës ndërkohë ka patur edhe reagime ndërkombëtare. Po nga Shqipëria a prisni ju një reagim?

Armatosja e Serbisë, është shqetësuese, dhe dënimet që i janë bërë nga disa vende janë të kuptueshme. Madje mund të ishin edhe më të fuqishme. Kur blihen armë dhe kur kjo shoqërohet me deklarata kërcnuese, të të gjitha llojeve, madje ndonjëherë bëhen edhe veprime provokuese në afërsi të kufirit, si mund të shihet ndryshe tërë kjo veçse si kërcnim serioz. Çfarë mendoj unë? Mendoj se kto veprime të Serbisë duhet të jenë të qortueshme nga të gjithë, pa përjashtim. Në interes të paqes dhe stabilitetit, madje edhe në interes së popullit të Serbisë.

– Z. Ambasador, e nisëm këtë intervistë duke folur për marrëdhëniet ekonomike dhe politike, ndërsa dy vendet tona i lidh diçka me shumë se sa disa



marrëveshje në letër. Jemi një komb! Ndaj përtej marrëdhënieve zyrtare cilat janë pritshmëritë e Kosovës ndaj Shqipërisë Mëmë, dhe cili është apeli Juaj?

Jemi një komb, me dy shtete. Nëse ndërtojmë dy shtete të zhvilluara, të prosepruara nderojmë kombin. Të dy vendet, Shqipëria dhe Kosova, përveç historisë dhe sentimenteve, shumicën e orientimeve strategjike i kanë të njëjta: në politiken e jashtme, përcaktimi për fqinjësi të mirë rajonale, integrimet euro-atlantike, orientimet për ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë, etj.

Ajo që mund të bëjmë, dhe duhet të bëjmë, është që të sillemi arsyeshëm brenda suazave realiste, të jemi të vetëdijshëm për potencialet brenda kësaj hapsire, të fokusohemi në maksimalizimin e shanseve në çdo aspekt. Para së gjithash potencialet ekonomike që mundësojnë vetmjaftueshmëri për zhvillim, bazuar në resurset tona. Nga Shqipëria pres të njëjtat veprime sikurse edhe nga shteti im, Kosova. Detyrimin e parë e kemi ndaj vetevetës, qytetarëve tanë, që të bëjmë shtete me sundim të ligjit, me institucione demokratike, gjyqësi profesionale dhe media të paanshme. Veprim të vendosur për reduktim të korupsionit dhe dukurive të



tjera negative që molisin infrastrukturën shtetërore dhe vullnetin e qytetarëve. Aktivizimi i potencialeve mbi këtë platformë juridike është supozim bazik se mund të shtoj motivet e brezit të ri që të realizohen në atdheun e tyre, në Kosovë apo në Shqipëri. Pra të bëjmë atë që varet nga ne që të ndalet kjo hemoragji nacionale. Për fat të keq, trendi i ikjes është i frikshëm, jo i lehtë për tu shpjeguar e edhe më pak për tu ndalur. Por le të bëjmë atë që varet prej nesh, dhe duhet besuar se do të bëhet punë e mirë.

Kjo është tabloja e madhe, makro. Në specifika mund të bëjmë më shumë për të përkrahur njëri-tjetrin, në të gjitha fushat. Kosova, me përvoja solide të ndërtimit të shtetit, me potenciale të mira ekonomike, është adresa e parë bashkëpunuese e Shqipërisë. Kosova që po ndërton shtet modern me standarde demokratike të avancuara, është argument i fuqishëm për Shqipërinë, për mbështetje në politikën e jashtme, në çdo nivel. Për fat të mirë Shqipëria është anëtare dhe e pranishme në shumë instanca e organizata ndërkombëtare ku Kosova ende nuk është anëtare. Kjo është përparësi edhe për ne. Kjo ndër të tjera, është edhe puna ime si diplomat në Tiranë. Jam optimist se për të gjitha këto do të nxjerrim më të mirat e mundshme.

